REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 97/17
Datë/Datum. 02.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova – Republic of Kosovo

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

---

## AKT PËRCJELLËS

| | | | |
|---|---|---|---|
| Për: | Menaxherin e prokurimit **Komuna e Prishtinës.** | Kopje: | Paneli Shqyrtues - OSHP |
| Prej: | Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit<br>Besim Mulaj – Ekspert Teknik. | | |
| Lënda: | Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. 97/17 e OE **"Luani"** - Prishtinë. | | |
| Datë: | 02.05.2017 | | |

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me Nr. **97/17** nga OE **"Luani"** – Prishtinë, për shqyrtimin e lëndës **"Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës"**, me nr. të Prokurimit: AP : **616/16/115/211** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna e Prishtinës.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

**Ti dorëzohet:**
- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PRISHTINËS.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **LUANI.**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **19.04.2017** | | **19.04.2017** | | **02.05.2017** |
| *Nënshkrimi i ekspertit* | | *Data e autorizimit të eksp.* | | *Data e fillimit të ekspertizës* | | *Data e dorëzimit të raportit* |

***N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit***

Me datën 05.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **97/17** e parashtruar nga **OE Kompania e sigurimit fizik" Luani" sh.p.k-** me seli në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës"**, me nr. të Prokurimit: AP : **616/16/115/211** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna e Prishtinës.**

Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna e Prishtinës.**

**N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "Luani, sh.p.k** me seli në Prishtinë

*Pikat e Ankesës nga OE* NSHT Kompania e sigurimit fizik **"Luani" sh.p.k** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Sipas dispozitav te Ligjit te LPP-së menoj qe nga njoftimi per kontrat e deri ne njoftimin per dhenje te saj ,qe ne fillim nuk eshte dhen specifikacione te mjaftushme sa i perket dosjes se tenderit dhe eshte dashur qe ne te kerkojm sqarim shtes. Ne sqarim shtes thuhet se oferta qe nuk mbulon pagen do te llogaritet si jo normalisht e ultë. Andaj ne mendoj se Ak-ja gjat vlerimit per dhenje te kontrates nuk ka repektu kriteret te cilat jan kerkua nga vet AK-ja.

*Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:*

Sipas Ligjit te LPP-se mendojm qe jan shkelur kerkesat qe vet i kan kerkuar ne dosje te tenderit . Sipas dosjes se tenderit kriter per dhenje ka qen qmimi ma i lir dhe eshte kerkuar paga 230.00 ero dhe te respektohet ligji i punes . Andaj ne baz te ksaj jan shkelur nenet si ne vijim . Neni 7 pika 1 neni 2 dhe 3 Neni 54 pika 1.2 Neni 56 pika 2 dhe 2.2 Neni 59 neni 3 neni 4 Neni 61 pika 1 Neni 68 pika 1

Nuk eshte permbush kriteri sipas dosjes se tenderit neni 8.1 , 8.2 ku ju keni kerkuar qe qe qarkullimi te 400.000.00 per 3 vitet e fundit dhe te deshmohet me raporte ndersa kompania qe je e keni shpall fitus ka dhen deshmi te knaqshme lidhur me ket kriter. Nuk eshte respektu kriteri tek neni 9. 1 qe vet eshte kerku qe te respektohet Ligji i punes Nr.03/L-212 dhe paga te jepet ne jo ma pak se 230.00 ero dhe se qmimi i dhen per nje ore pune 1.63 nuk e mbulon pagen e puntortit duke mos llogaritur edhe detyrimet tjera,sepse vetem paga e puntorit del te jet 1.637 pa llogaritur ligjin e punes pa llogarit fitimin e kompanis . Deshmi: pjesa e pytjev shtes dhe pergjigjejev nga AK-ja Sipas nje perllogaritje 230.00 bruto pag + 11.50 tatim x 18 % TVSH del te jet si ne vijim 230.00+11.50=241.50 x 18%TVSh 43.47 =284.97 kur i pjestojm me 174 punë del tejet ora e puntorit 1.6377 Andaj Kompania qe eshte shperbly me kontrat nuk e ka plotsuar kriterin e pages se larticekur.

**Procesi i prokurimit:**

*Data e njoftimit për kontratë në KRPP :* .....28.12.2016

*Lloji i procedurës së aplikuar:*..... Procedurë e hapur

*Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:* .....Sherbime/vlerë e mesme

*Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):* .....24.01.2017

*Data e hapjes së ofertave* .....24.01.2017-14:30h

*Kriter për dhënie të kontratës:*.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

*Lloji i kontratës:*.....*Kontratë kornize – 36 muaj*

**Kriteret për vlerësim**

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1.Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1.Operatori Ekonomikduhet tëpërmbushëkërkesat e specifikuaranënenin 65 tëLigjittëProkurimitPublik (LPP), Ligjinr 04 \ L-42. LPP mundtëshkarkohetngahttp://krpp.rksgov.net.

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

Deklaratënnënbetim se operatoriekonomikpërmbushkërkesatmbipërshtatshmërinëtëLigjitNr. 04/L-042 , Neni 65, kërkohetorigjinali- Plotësimi i AneksitNr. 2 teDosjes se Tenderit

2. Njëvërtetimngaadministratatatimore e vendittëthemelimittëoperatoritekonomik, se operatoriekonomiknëfjalënukështë me vonesëpërpagimin e tatimevesëpakuderinëtremujorin e fundittëvitit para dorëzimittëtenderit.- kërkohetorigjinaliosekopjavetëmngaOperatoriEkonomikqepropozohetpërshpërblimtekontratës dhe dorëzohetteAutoritetiKontraktues para publikimitteNjoftimitpërDhënietëKontratës.

3. Dëshmi se kompanianukështë ne falimentimosenënadministrimtedhunshëmgjyqësoreteléshuarngaGjykata - kërkohetorigjinaliosekopjavetëmngaOperatorinEkonomikqepropozohetpërshpërblimtekontratës dhe dorëzohetteAutoritetiKontraktues parapublikimitteNjoftimitpërDhënietëKontratës.

Dështimi i OperatoritEkonomikqeështëpropozuarqeteshpërblehet me kontratetesjelledokumentettekërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jepëtëdrejtëAutoritetitKontraktuesqeofertën ta refuzoj, ta bejekonfiskimin e

garancionitpërsigurimteofertës dhe tevazhdoj me shpërblimtekontratës me OperatorinEkonomikqeështërendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.

III.2.2) Përshtatshmëriaprofesionale:
1.Kërkesa 1.Regjistrimi nëregjistrinprofesionaltëndërmarrjeve
2.Kërkesa 2.Regjistrimi i numritfiskal ne ATK
3.Kerkesa 3.Licencimi nga MPB
4.kerkesa 4. Vertetimipërfrekuencatngarregullatori I telekomunikacionit
*Dëshmia e kërkuardokumentare:*
1. VërtetimingaMinistriapërregjistrim-çertifikata e biznesit me llojin e veprimtarivetëregjistruara dhe
2.Dëshmia 2.Çertifikata e numritfiskal-kopje
3..Kopjet e licensavengaMPB
4. Deshmi se posedonleje per perdorimin e frekuencavenga ART

III.2.3) Kapacitetiekonomik dhe financiar
1.OE-ik duhettëofrojdëshmitëkënaqshme se kaqarkullimfinanciar ne trevitet e fundit(2013, 2014 dhe 2015) nëvlerënminimaleprej400,000.$^{00}$ €
*Dëshmia e kërkuardokumentare:*
1.Raportin bankarapokonfirmiminngabanka per qarkullimin e kërkuar

III.2.4) Kapacitetiteknik dhe profesional
- OE duhetteofrojdeshmitemjaftueshme per kryerjen e sherbimevetengjashme ne trevitet e fundit(2013, 2014 dhe 2015).

Dëshmia e kërkuardokumentuese:
1. Lista e projektevetërealizuaranëtrevitet e fundit (2013, 2014, 2015) përshërbimetengjashmedëshmuar me kopjet e referencaveapoçertifikatavetepranimevenë 3 vitet e fundit nëvlerën minimale prej400,000.$^{00}$ €.

**Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:**

| Nr | Operatoret ekonomik | Vendi | Çmimi total për njësi € | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|
| 1. | "Rojet e nderit" | Prishtinë | 1.77 | JO |
| 2. | "K ing Security" | Prishtinë | 1,7463 | JO |
| 3. | "Alpha security" | Prishtinë | 1.63 | JO |
| 4. | "Security code" | Prishtinë | 1,966 | JO |
| 5. | "Syri group" | Prishtinë | 1,637 | JO |
| 6. | "Luani" | Prishtinë | 1,749 | JO |
| 7 | "Delta security" | Prishtinë | 1,204 | JO |
| 8. | "International" | Prishtinë | 1,85 | JO |

**Komisioni vlerësues pranë AK:**

*Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.*

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Mehmet Recani - Kryetar i komisionit
- Skender Brajshori - Anëtar i komisionit
- Ramadan Osmani - Anëtar i komisionit

*Data e mbarimit të vlerësimit:* .....15.03.2017

*Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:*.....22.03.2017

*Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :*.....24.03.2016

**Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:**

| Nr | Operatoret ekonomik te pergjegjshem | Vendi | Çmimi total për njësi € |
|---|---|---|---|
| 1. | "Rojet e nderit" | Prishtinë | 1.77 |
| 2. | "K ing Security" | Prishtinë | 1,7463 |
| 3. | "Alpha security" | Prishtinë | 1.63 |
| 4. | "Security code" | Prishtinë | 1,966 |
| 5. | "Syri group" | Prishtinë | 1,637 |
| 6. | "Luani" | Prishtinë | 1,749 |
| 7 | "Delta security" | Prishtinë | 1,204 |

**Raporti i komisionit vlerësues:**

Pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave komisioni e ka rekomanduarper kontrat OE "Alpha security".

**Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:**

**Sqarimi nr.1**

OE Luani pretendon se OE fitues nuk përmbush kriterin e pagesës prej 230 euro bruto qe duhet ti paguhet punëtorit .

Eksperti teknik sqaron se OE fitues e ka plotësuar kriterin prej 230 euro bruto page për punëtorin dhe me poshtë do japim një sqarim konkret se si është plotësuar ky kusht nga OE fitues.

Paga 230 euro bruto nënkupton se ne te janë te përfshira te gjitha taksat dhe kontributet e obligueshme dhe ne rastin konkret nëse marrim numrin e punëtorëve dhe orëve qe do te angazhohen llogaria behet ne ketë mënyrë:

230 Euro X 62 punëtor = 14260 euro paga për 62 punëtor dhe nëse i shtojmë edhe TVSH 18% do te kemi ketë llogaritje:
14260 euro paga x 18% TVSH = 16826.80 euro paga dhe nëse ketë e pjesëtojmë me numrin e orëve 10800 ore pune atëherë kemi ketë llogaritje,
16826.80 euro (gjithesejt paga për 62 punëtor përfshirë edhe TVSH 18%) dhe ketë e pjesëtojmë me numrin e orëve 10800 ore atëherë kemi ketë llogaritje
16,826.80/10800=1.559 euro për ore qe do te thotë se OE fitues e plotëson kriterin e pagesës prej 230 euro bruto siç është kërkuar ne dosje te tenderit sepse OE fitues çmimin për ore ka ofruar ne vlere prej 1.63 euro.
Ketë e bazoj edhe ne kalkulimin e pagesë bruto nga kalkulatori i pagave ne faqen zyrtare te ATK-së (gjeni te bashkangjitur ketë dokument) ku shpjegohet kalkulimi nga shihet se janë te përfshira te gjitha taksat dhe kontributet për te rezultuar paga prej 230 euro.
Andaj, duke u bazuar ne sqarimin e mesiperm vlerësoj se ky pretendim i OE ankues eshte i paqendrueshem.

**Sqarimi nr.2**
Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar per kontrat nuk e përmbush kerkesen per qarkullim 400,000.00 euro. Eksperti shqyrtues, pasi ka ekzaminuar oferten e te rekomanduarit per kontrat sqaron se ne oferten gjendet qarkullimi bankar mbi 500,000.00 euro per tri vitet e fundit, prandaj ky pretendim i OE ankues eshte i paqendrueshem.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues :**

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Komuna e Prishtinës**, për aktivitetin e prokurimit **"Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës", me nr. të Prokurimit: 616/16/115/211,** nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 28 te LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues-teknik i propozojn panelit shqyrtues që ta aprovojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës, ndersa ankesa e OE ankues te refuzohet si e pabazuar.